

URDHËR
Nr. 85, datë 24.3.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në zbatim të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të bëra në nenet 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenin 21, pika 5, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 73, pika 2, të VKM-së nr. 285/2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave menaxheriale dhe vendimmarrëse të titullarit të autoritetit kontraktor të SUOGJ-së “Mbretëresha Geraldinë”, në lidhje me zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me fonde buxhetore, zëvendës drejtorit Ekonomik/Administrativ të këtij institucioni, znj. Arta Hajro.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të autoritetit kontraktor do të ushtrohen për një periudhë të pacaktuar, nga hyrja në fuqi e këtij urdhri deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Arta Hajro me detyrë zëvendës drejtor Ekonomik/Administrativ i SUOGJ-së “Mbretëresha Geraldinë”.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR
Eliona Demaliaj